# PLANI I REKRUTIMEVE PËR VITIN 2020

Edhe pse një institucion i pavarur i krijuar me ligjin e veçantë Nr.45/2013, *"Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), procedurat e rekrutimit të punonjësve të përcaktuar në strukturën dhe organikën e tij, miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, *"Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"*, i kryen mbështetur në ligjin nr.152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, akteve nënligjore përkatëse të nxjerra në zbatim dhe plotësim të këtij ligji, nga Këshilli i Ministrave, si dhe praktikave dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike (DAP), nëpërmjet shpalljes dhe njoftimeve publike për konkurim të hapur, për vendet vakante, në pozicionet përkatëse.

Me vendimin e Autoritetit Nr.727, datë 21.11.2019, është miratur plani i mëposhtëm i rekrutimeve, për vitin 2020.
Pjesë e planit të rekrutimeve për vitin 2020, janë edhe pozicionet e mbetura vakante nga plani i rekrutimeve për vitin 2019.

| Kategoria | Klasa | Pozicioni | Sektori | Drejtoria | Nr. Vakancave | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kod Pune | VI | Magazinier | Logjistikës dhe Mirëmbajtjes | Shërbimeve të Brendshme dhe Financave | 1 | vakant |
| | I | Pastrues | | | 1 | plotësuar |
| Mesme drejtuese | II-B | Drejtor | | | 1 | vakant |
| Ulët drejtuese | III-A | Përgjegjës | Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit | | 1 | vakant |
| Ekzekutive | III-B | Specialist | Juridik dhe Prokurimeve | | 1 | vakant |
| | | | Projekteve Studimore dhe Audiovizuale | Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve | 1 | vakant |
| | | | Kërkesave Individuale për Informim | Informacionit | 3 | vakant |
| | | | Kërkesave për Informim nga Institucionet | | 1 | vakant |
| | | | Dixhitalizimit dhe Fotokopjes | Arkivit | 1 | vakant |

**Të gjithë personat e interesuar janë të lutur të ndjekin, në vazhdimësi, njoftimet për shpalljen dhe zhvillimin e procedurave përkatëse të rekrutimit, për vendet vakante, të publikuara në:**

- faqen zyrtare të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH);
- stendën përkatëse të publikimit të njoftimeve, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH);
- Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.